

L I G J
Nr.8500, datë 10.6.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET
SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE
KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, pikat 8 dhe 9 riformulohen si vijon:

“8. Në termin “Grupi i parë” do të përfshihen:

a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Këshillit të Ministrave, Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, ministrat, Zëvendëskryetari i Kuvendit dhe të barazuar me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

b) Deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe Avokati i Popullit.”

“9. Në termin “Grupi i dytë” do të përfshihen:

a) Sekretarët e Shtetit, zëvendësministrat, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, sekretarët e përgjithshëm dhe funksionarët politikë pranë Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrave, institucioneve qendrore, prefekturave, këshillave të rretheve, bashkive dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

b) Personat që kryejnë detyra në administratën e Presidentit, të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrave dhe institucioneve qendrore, të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit, prokurorive të rretheve, prefekturave dhe të pushtetit vendor dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Personeli drejtues ku do të përfshihen: drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, në funksion dhe pagë, personat të cilët punojnë në organet drejtuese të pushtetit vendor dhe në funksione të tjera drejtuese, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

d) Personeli specialist ku do të përfshihen specialistët dhe personat e tjerë të barazuar me ta në funksion dhe pagë, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Në nenin 7, pas paragrafit të tretë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Personat, të cilët gjatë periudhës së përfitimit të pagesës kalimtare janë të punësuar në një funksion kushtetues, që përfshihet në këtë ligj, pas largimit nga ky funksion, do të marrin pagesë kalimtare vetëm për atë periudhë shërbimi në funksion, gjatë së cilës nuk janë trajtuar edhe me pagesë kalimtare nga funksioni paraardhës.

Periudha, gjatë së cilës personat nuk janë të punësuar dhe përfitojnë shpërblim të menjëhëshëm dhe pagese kalimtare, njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, familjar dhe invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror për këta persona derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit.”

Neni 3

Në nenin 8 pika 2 shkronja “a” pas fjalës “funksion” shtohen fjalët “... me përjashtim të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave.”

Neni 4

Në nenin 8, pas pikës 2/b të shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:
“Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e mësipërme, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.”

Neni 5

Në nenin 10 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:
“Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e mësipërme, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.”

Neni 6

Në nenin 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Kanë të drejtë të marrin përfitime shtetërore suplementare presidentët e Republikës, që kanë qenë në këtë funksion prej datës 1 prill 1991. Përfitimet e mësipërme do të jepen që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. Efektet financiare, për pagimin e këtyre përfitimeve, të përballohen nga buxheti i shtetit.”

Neni 7

Neni 19 ndryshon si vijon:
“E drejta për përfitim shtetëror suplementar nuk parashkruhet.
Personit, që kërkon përfitim shtetëror suplementar brenda një viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky përfitim që nga kjo datë. Në raste të tjera, përfitimi do të paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.”

Neni 8

Neni 25 ndryshohet si vijon:
“Personat, të cilët njëkohësisht përfitojnë shtesë ose pension të posaçëm shtetëror dhe pension shtetëror suplementar kanë të drejtë të zgjedhin pensionin më të favorshëm.”

Neni 9

Neni 28 i ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 29 shtohet një paragraf i ri, me këtë përmbajtje:

“Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktin nënligjor të përbashkët, për mënyrën e dhënies dhe për pagimin e shpërblimit të menjëhershëm.”

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2403, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**